



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 134, datë 28.10.2021

PËR
PËRCAKTIMIN E MËNYRËS DHE RREGULLAVE PËR FALJEN E MASAVE
ADMINISTRATIVE ME KARAKTER NDËSHKUES TË VENDOSURA NGA
BASHKIA DURRËS, NË PERIUdhËN 23 SHTATOR – TETOR 2020, NDAJ
FAMILJEVE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSITË NATYRORE, TËRMETET E
DATËS 21 SHTATOR DHE 26 NËNTOR 2019

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, nenit 113, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore, Aktit normativ nr. 31, datë 7.10.2020 “Për faljen e masave administrative me karakter ndëshkues të vendosura gjatë periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19 dhe familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore”, Udhëzimit nr. 38, datë 19.10.2020 “Për faljen e masave administrative me karakter ndëshkues, të vendosura gjatë periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19, si dhe ndaj familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore”, si edhe sipas relacionit të përgatitur nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të bashkisë Durrës, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Faljen e masave administrative të vendosura në periudhën 23 shtator – tetor 2020 nga

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit ndaj familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore, tërmetet e datave 21 shtator dhe 26 nëntor 2019, për shkeljet e konstatuara gjatë kryerjes së punimeve për riparimin/rindërtimin e banesave individuale.

2. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit përgatit listën e subjekteve ndaj të cilëve është vendosur masa administrative me gjobë gjatë periudhës 23 shtator 2019 – tetor 2020, për shkeljet e konstatuara gjatë kryerjes së punimeve për riparimin/rindërtimin e banesave individuale.
3. Lista e hartuar sipas pikës 2 të këtij vendimi përcillet pranë Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për të koordinuar dhe vërtetuar me njësitë administrative/lagjet, familjet dhe individët që kanë kryer punime për riparimin/rindërtimin e banesave individuale, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga tërmetet e datave 21 shtator dhe 26 nëntor 2019.
4. Pas kryerjes së procedurës së mësipërme, Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike përcjell zyrtarisht listën e subjekteve që përmbushin kriteret e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit.
5. Subjektet, që rezultojnë se kanë paguar shumën e detyrimit, me qëllim kthimin e kësaj shume duhet të dorëzojnë pranë IMT-së, dokumentacionin si më poshtë:
 - a) emër, mbiemër individit
 - b) ID kartë identiteti
 - c) emrin e bankës pranë së cilës kanë llogarinë personale
 - d) vërtetimin bankar që llogaria bankare ku do të arkëtohet kthimi gjobës është aktive.
6. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit brenda 10 ditëve dërgon një kopje të listës së subjekteve përfituese me të dhënat përkatëse pranë Sektorit të Financës, Drejtoria Ekonomike e cila harton urdhërpagesat për vlerat totale për edo bankë të nivelit të dytë ku është kryer arkëtimi i gjobës.
7. Kthimi i shumës së detyrimit të falur, por të paguar, të kryhet sipas procedurës të ndjekur për kthimet nga Drejtoria Ekonomike, Sektori i Financës.
8. Pas ezaurimit të procedurës të parashikuar në këtë vendim, Drejtoria Ekonomike, Sektori i Financës, njofton Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit mbi listën e subjekteve përfituese që ju është hequr/fshirë masa administrative me gjobë nga sistemi duke specifikuar edhe individët/subjektet, që ju është kthyer shuma e detyrimit të paguar.
9. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria Ekonomike, Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike

pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Njësitë Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).


KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.10.2021





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 868/8 prot.

Durrës, më 04.11.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.134 datë 28.10.2021 “Për përcaktimin e mënyrës dhe rregullave për faljen e masave administrative me karakter ndëshkues të vendosura nga Bashkia Durrës në periudhën 23 Shtator – Tetor 2020, ndaj familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore, tërmetet e datës datave 21 Shtator dhe 26.11.2019”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

